

VENDIM
Nr. 19, datë 21.3.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENREL HYDRO” SHPK
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 8 dhe 10, pika 3 të rregullores” Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EnRel Hydro” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe është pa plotësuar germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10) është plotësuar pjesërisht: janë pa plotësuar gjerat “a” dhe “b” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar, kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikat e sipërcituara, do t’i kërkohej subjektit të depozitohet në ERE brenda afateve të përcaktuara në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plot dhe të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Petrit Ahmeti

KRYETARI